

MODELI PËR DOKUMENTIN KONSULTATIV

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014, “Për armët””

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”.

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektligjit, kryesisht për shtesat dhe ndryshimet në nenet përkatëse, mbi:

- Llojet e licencave;
- Licenca për import dhe tregtimin e armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre;
- Kriteret e përgjithshme të licensimit.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektligjit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen në projektligj.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë të paktën 20 ditë pune sikurse kërkon ligji, nëpërmjet publikimit në RENJK, nga data 23 dhjetor 2022 deri më 24 janar 2023.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektligjin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrisë Elektronike për projektaktin, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>.
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e:
- Koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Besmira Hoxha, në adresën: besmira.hoxha@mb.gov.al

- Specialistit të Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator silvi.tola@mb.gov.al

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

znj. Besmira Hoxha - Koordinatore e Konsultimit Publik për MB, e-mail besmira.hoxha@mb.gov.al

znj. Silvi Tola – Specialiste e Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, e mail silvi.tola@mb.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”” është hartuar nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore për Çështjet e Brendshme, në Ministrinë e Brendshme.

Në datën 13.12.2022 në ambientet e Ministrisë së Brendshme është zhvilluar takim me dy përfaqësuesit e DPPSH dhe dy përfaqësues nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, të cilët kanë dakordësuar draftin e projektligjit të propozuar. Gjithashtu, ka kontribuar edhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave për Rendin dhe Sigurinë Publike.

Projektligji është dërguar për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Mbrojtjes, në muajin dhjetor 2022.

Sfondi i propozimit legjislativ

Projektakti, konkretisht projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”” ka për qëllim plotësimin e vakumit ligjor, të krijuar në vijim të miratimit të ligjit nr. 152/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, lidhur me përcaktimin e autoritetit përgjegjës për lëshimin e licencës për tregtimin e armëve të kategorisë “B”, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve.

Nevoja për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 74/2014 ka ardhur si pasojë e kërkesës së grupeve të interesit, lidhur me çështjen e tregtimit të armëve të kategorisë “B”, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve. Ligji nr. 74/2014, “Për armët”, i ndryshuar, njeh të drejtën e tregtimit të armëve, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Me ndryshimet e ligjit nr. 152/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, u synua përputhshmëria me objektivin nr. 1, të strategjisë për Kontrollin e Armëve të vogla dhe të Lehta 2019 – 2024, ku përcaktohet që brenda vitit 2023, të garantohet

miratimi i legjislacionit për rregullimin e armëve, me qëllim dhe harmonizimin e plotë me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian, detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse, si dhe standardizimi me rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Në këtë kuadër, u përafua direktiva (BE) 2017/853, e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 maj 2017, që ndryshon direktivën e Këshillit 91/477/KEE, datë 18 qershor 1991, “Për kontrollin e blerjeve dhe posedimit të armëve”, u njësuat përkufizimet e kategorive të armëve, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve, u përcaktuan kategoritë të cilat lejohen/nuk lejohen për përdorim nga personat fizikë e juridikë, shtuan kriteret mbi krijimin e regjistrimit elektronik të armëve, si dhe forcuan, në tërësi, masat për dhënien e licencave mbi veprimtaritë e lejuara me armët. Lidhur me sa më sipër, një nga ndryshimet përfshinte edhe ndarjen e kompetencave për lëshimin e licencave, sipas kategorive të armëve.

Në vijim të ndryshimeve të ligjit nr. 74, datë 10.07.2014, “Për armët”, miratuar me ligjin nr. 152, datë 17.12.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014, “Për armët””, është krijuar një vakum ligjor, i cili përbën pengesë për rinovimin e licencës, lidhur me tregtimin e armëve të kategorisë “B1” dhe “B4”.

Sa i përket kategorive “C” dhe “D”, në bazë të ligjit të sipërcituar dhe vendimit nr. 421, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave, dokumentacionin, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit të veprimtarive të lejuara me armët”, i ndryshuar, subjekti, me përfundimin e afatit të licencës, ka të drejtën e paraqitjes së kërkesës për licencë të re, sipas kriterëve të reja të miratuara.

Propozimet

Propozimet konsistojnë konkretisht në disa shtesa dhe ndryshime mbi:

- *“licencën për tregtimin e armëve të kategorisë “B” dhe për import dhe tregtim të armëve të kategorisë “C” (gjahut) dhe “D” (sportive), pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.”*
- *“licencën për tregtimin e armëve të kategorisë “B” dhe për import dhe tregtim të armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.”*
- *“veprimtarinë e tregtimit të armëve të kategorisë “B”, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji, lëshohet licencë nga komisioni përgjegjës në Policinë e Shtetit”.*

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projekt-ligjit të propozuar.

- Si i vlerësoni përcaktimet në projektligj, në nenet përkatëse, kryesisht mbi:
 - Llojet e licencave;
 - Licenca për import dhe tregtimin e armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre;
- A jeni dakord me parashikimet e përcaktuara në projektligj, në nenin përkatës, kryesisht për:
 - Kriteret e përgjithshme të licensimit.